

Kouleta SA, me seli në Gjenevë të Zvicrës, për degën e saj Kouleta SH.P.K në Kosovë/Prishtinë shpall konkurs për pozitën:

Kontabilist – 2 pozita

Kualifikimet:

- Të ketë Diplomë Universitare të Fakultetit Ekonomik – obligative të jetë Kontabilist/e i/e certifikuar në SCAAK (dëshmi: certifikatat);
- Aftësi në organizimin dhe menaxhimin e punës dhe marrëdhënies me stafin tjetër administrativ;
- Shkathtësi kompjuterike të sistemit operativ Windows 10 dhe programeve tjera aplikative;
- Të ketë njohuri shumë të mirë të paketës, Microsoft Office (veçanërisht Excel);
- Të ketë njohuri shumë të mirë të gjuhës angleze (në të folur dhe të shkruar), frëngjishtja është një përparësi e rëndësishme;
- I përpiktë në punët e përditshme;
- Njohja e programeve të kontabilitetit do të jetë përparësi (e preferuar);
- Përvoja punës relevante në kontabilitet (e preferuar).


Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Regjistrimet kontabël të transaksioneve të biznesit (Klientë zviceran);
- Lëshimi dhe regjistrimi i faturave të shitjes dhe të gjitha dokumenteve tjera dalëse;
- Përgatitja e pasqyrave financiare, dhe ajo e deklaratave tatimore të personave juridik dhe fizik (klientë zviceran);
- Të ndihmojë menaxherin në krijimin, transformimin dhe mbylljen e kompanive;
- Ofron informata relevante dhe me kohë sipas kërkesave të menaxhmentit të kompanisë;
- Kryen detyrat dhe punët në përputhje me manualët e aplikueshme brenda kompanisë si dhe punë të tjera administrative në rast nevojë.

Kushtet e punës:

- Vendi i punës është në qytetin e Prishtinës, lagjja Arbëria;
- Kontrata bazuar në Ligjet e Punës së Kosovës;
- Paga mbi mesataren.

Të interesuarit të dërgojnë CV përmes postës elektronike: [info@kouleta.ch](mailto:info@kouleta.ch) ose mund të na kontaktojnë në numrat tanë të telefonit:

+38344437625 

+41763552460 